

**PROJEKT PROTOKOLL SHITESË  
NDËRMJET  
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
DHE  
SEKRETARIATIT TË PËRGJITHSHËM TË QEVERISË SË MALIT TË ZI  
PËR “INTENSIFIKIMIN E BASHKËPUNIMIT NË LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË  
PERSONAVE DHE PËR PËRMIRËSIMIN E IDENTIFIKIMIT, NJOFTIMIT, REFERIMIT  
DHE KTHIMIT VULLNETAR TË ASISTUAR TË VIKTIMAVE/VIKTIMAVE TË  
MUNDSHME TË TRAFIKIMIT”**

Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Malit të Zi, në vijim të quajtura “Palë” të këtij Protokollit Shtesë, këtej e tutje “Protokollit”

Duke u bazuar në pikën 3, të nenit 3 të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi “Për bashkëpunim në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm dhe aktiviteteve të tjera ilegale”, nënshkruar në Podgoricë, më 31.10.2003;

Duke marrë në konsideratë nenin 25 të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi, “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi për bashkëpunimin policor ndërkufitar”, nënshkruar në Podgoricë, më 01.02.2008;

Duke u mbështetur në legjislacionin përkatës kombëtar dhe ndërkombëtar, veçanërisht, në Protokollin për Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar, Konventën e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, si dhe në Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi “Për ripranimin e personave, hyrja ose qëndrimi i të cilëve është i paligjshëm”.

Me qëllim intensifikimin e bashkëpunimit në fushën e luftës kundër trafikimit të personave dhe mbrojtjes së viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;

Palët bien dakord për sa më poshtë:

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Protokollin synon të rrisë bashkëpunimin midis Autoriteteve Përgjegjëse të Palëve me qëllim:

- a. Intensifikimin e përpjekjeve të ndërsjella në luftën kundër trafikimit të personave të rritur dhe fëmijë/të mitur për t’iu përgjigjur nevojave dhe tendencave të reja të këtij fenomeni;
- b. Intensifikimin e shkëmbimit të informacionit, bashkëpunimit, si dhe ndihmës reciproke për sa i përket identifikimit, referimit, mbrojtjes, si dhe kthimit vullnetar të asistuar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;

- c. Shkëmbimin e eksperiencave pozitive dhe unifikimin e praktikave, procedurave dhe metodologjisë së punës në drejtim të luftës kundër trafikimit të personave për të gjitha aspektet, si për identifikimin, referimin, kthimin vullnetar të asistuar dhe mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit në përputhje me legjislacionin kombëtar;
- e. Caktimin e personave të kontaktit në Autoritetet Përgjegjëse respektive të përcaktuara sipas këtij Protokoll për administrimin dhe mbikëqyrjen e bashkëpunimit sipas mënyrave të përcaktuara në Nenin 4 të këtij Protokoll, dhe sa herë që është e nevojshme, për të ndihmuar në zgjidhjen e rasteve apo problemeve specifike.

## Neni 2 Përkufizime

Në kontekstin e zbatimit të këtij Protokoll, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

- a. **“Trafikim i personave”** është rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose të gjendjes së dobët, ose të dhënies apo marrjes së pagesave apo përfitimeve (shitja, blerja ose dorëzimi) për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër me qëllim shfrytëzimin. Shfrytëzimi përfshin, të paktën, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës apo shërbimeve të detyruara (lypje, martesë e detyruar), skllavërimin ose formave të tjera të ngjashme me skllavërimin, robërimin ose heqjen e organeve;
- b. **“Trafikimi i të miturve/fëmijëve”** është rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja, shitja apo marrja e një fëmije me qëllimin e shfrytëzimit edhe në ato raste kur nuk përfshin ndonjë nga mjetet e parashtruara në pikën (a) të këtij neni;
- c. **“Viktimë e trafikimit”** nënkupton çdo person fizik që është objekt i trafikimit të personave sipas përkufizimit në nenin 4, pika “e” e Konventës së Këshillit të Evropës, “Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”;
- d. **“Fëmijë/i mitur, viktimë e trafikimit”** është çdo person i lindur gjallë deri në moshën 18 vjeç, kundër të cilit është kryer akti i trafikimit siç përcaktohet në nenin 3/b të këtij Protokoll. Në rastin kur mosha e personit nuk është e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është një fëmijë/i mitur, ky person duhet të konsiderohet si i tillë dhe përfiton nga ky Protokoll derisa mosha e personit të përcaktohet plotësisht;
- e. **“Viktimë e mundshme e trafikimit”** është çdo person fizik që ndodhet në një situatë serioze, konkrete dhe aktuale, i cili identifikohet si i tillë në bazë të kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm i secilës Palë duke marrë në konsideratë edhe zbatimin e akteve ndërkombëtare në të cilat Palët bëjnë pjesë;
- f. **“Pëlqimi i viktimës së trafikimit”** për shfrytëzimin e synuar të parashtruar në pikën (a) të këtij neni, nuk merret parasysh në rastin e përdorimit të mjeteve të parashtruara në pikën (a) të këtij neni. Në rastin e të miturve viktimave/viktima të mundshme të trafikimit, pëlqimi i të miturit/miturës nuk merret parasysh në asnjë rast;
- g. **“Fëmijë/i mitur i pashoqëruar - viktimë e mundshme e trafikimit”** është çdo person nën 18 vjeç, i cili jeton në territorin e një prej Palëve nënshkruese të këtij Protokoll, i pashoqëruar nga prindërit dhe kujdestari ligjor.

## II

### FUSHA E ZBATIMIT DHE CAKTIMI I AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE

### **Neni 3**

#### **Format dhe mënyrat e bashkëpunimit**

1. Ky Protokoll zbatohet për të gjitha format e trafikimit të personave me natyrë ndërkuftare.
2. Autoritetet Përgjegjëse të caktuara nga secila Palë në këtë Protokoll, do të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre, më konkretisht duke:
  - a) shkëmbyer rregullisht informacione me anë të të cilave do të bëhet i mundur parandalimi, identifikimi, dokumentimi i veprave penale që lidhen me trafikimin e personave që kryhen midis Palëve. Ky shkëmbim informacioni do të realizohet periodikisht, dhe nëse e kërkojnë rrethanat, menjëherë. Informacioni për rastet e identifikuar do të përmbajë të gjitha të dhënat e duhura për të mundësuar një identifikim, referim dhe mbrojtje sa më të sigurt dhe në interesin më të lartë të viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit; Autoritetet Përgjegjëse të të dy Palëve janë përgjegjëse për hartimin e një formati për shkëmbimin e informacionit dhe mënyrën e shkëmbimit të tij, format i cili është pjesë e aneksit të këtij Protokoll.
  - b) marrë masa konkrete me veprime të përbashkëta me qëllim parandalimin e trafikimit dhe shfrytëzimit, si dhe mbulimin e një fushe sa më të gjerë të nevojave, tendencave dhe specifikave të ndryshme të fenomenit. Shkëmbimi i informacionit nuk do të kufizohet vetëm për rastet e trafikimit, por edhe për situata të tjera, sidomos të rasteve të fëmijëve dhe grave të shfrytëzuara apo në situatë të rrezikuar nga trafikimi;
  - c) organizuar takime të ekspertëve në nivel qendror nga Autoritetet e caktuara Përgjegjëse sipas këtij Protokoll, çdo gjashtë muaj, për të rishikuar zbatimin e këtij Protokoll; takime të planifikuara dhe, sipas nevojës, takime lokale, për zgjidhjen e çështjeve operative urgjente, rasteve të veçanta ose problemeve që kanë lidhje me trafikimin e personave ose me identifikimin, njoftimin, referimin dhe kthimin vullnetar të asistuar të viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit;
  - d) Autoritetet Përgjegjëse të Palëve do të kenë në vëmendje të veçantë kërkesat e njoftimit, referimit, mbrojtjes dhe kthimit vullnetar të asistuar në territoret e tyre përkatëse të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit; shëndetin, moshën, mirëqenien dhe nevojat e këtyre personave për mbrojtje; të drejtat e tyre sipas instrumenteve përkatës ndërkombëtarë për periudhën e reflektimit, qëndrimin apo zhvendosjen e përhershme ose të përkohshme.

### **Neni 4**

#### **Autoritetet Përgjegjëse**

1. Autoritetet Përgjegjëse për zbatimin e këtij Protokoll janë:

Për Republikën e Shqipërisë:

- Ministria e Punëve të Brendshme nëpërmjet Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave

Për Qeverinë e Malit të Zi:

- Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Malit të Zi/Zyra për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

### III

## IDENTIFIKIMI, REFERIMI, MBROJTJA DHE KTHIMI VULLNETAR I ASISTUAR I VIKTIMAVE/VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT

### Neni 5

#### Identifikimi dhe referimi i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit

1. Autoritetet Përgjegjëse të Palëve angazhohen për identifikimin dhe referimin në kohë dhe sipas legjislacionit të tyre të brendshëm të të gjitha viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, shtetas të Shqipërisë dhe Malit të Zi;
2. Procesi i identifikimit do të zhvillohet duke u bazuar në sistemin dhe mekanizmat formalë të identifikimit të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të parashikuar në legjislacionin e brendshëm të Palëve;
3. Për sa të jetë e mundur, Palët do të unifikojnë procedurat e tyre të identifikimit dhe referimit të rasteve të trafikimit të personave me qëllim aplikimin e standardeve më të mira, duke pasur gjithmonë në qendër të vëmendjes interesin më të lartë të viktimës;
4. Për të gjitha rastet e identifikuara, Autoritetet Përgjegjëse të Palëve do të krijojnë dosje të veçantë për çdo person të identifikuar si viktimë/viktimë e mundshme e trafikimit. Autoriteti Përgjegjës i Palës që kryen identifikimin fillestar të rastit cakton një Menaxher Rasti. Në bashkëpunim me organet e tjera të përcaktuara në pikën 3 të nenit 7, të këtij Protokoll, Menaxheri i Rastit kryen një analizë të rrezikut dhe nevojave të rastit, si dhe harton planin e veprimit dhe të asistencës së rastit.

### Neni 6

#### Njoftimi paraprak

1. Palët duhet të njoftojnë paraprakisht njëra-tjetrën për të gjitha rastet e identifikuara të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit kur ata janë shtetas të Palës tjetër;
2. Njoftimi paraprak bëhet menjëherë sapo autoritetet e shtetit pritës të kenë arritur në konkluzionin se kanë të bëjnë me një viktimë/viktimë të mundshme trafikimi, por jo më vonë se 7 ditë nga momenti i identifikimit;
3. Për rastet e identifikuara ku viktimat/viktima e mundshme e trafikimit është fëmijë/i mitur, njoftimi duhet të jetë i menjëhershëm, me qëllim që të sigurohet edhe informimi i prindit apo kujdestarit ligjor të fëmijës;
4. Pas njoftimit paraprak, shteti Palë do të marrë të gjitha masat për vlerësimin e rrezikut dhe sigurimin e kushteve për kthimin vullnetar të asistuar të viktimës;
5. Njoftimi paraprak do të bëhet nëpërmjet pikave të kontaktit të përcaktuar në këtë Protokoll. Informacioni do të përcillet nëpërmjet rrugëve të sigurta të komunikimit për të cilat palët kanë rënë dakord paraprakisht;
6. Informacioni i rastit është dokumentacioni shoqëruar që i përcillet Autoritetit Përgjegjës të Palës tjetër.

### Neni 7

#### Kthimi vullnetar i asistuar i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit

1. Palët do të marrin masat e duhura për të lehtësuar kthimin vullnetar të asistuar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit në një kohë sa më të arsyeshme dhe duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurisë dhe mbrojtjes sociale të viktimës;
2. Pas marrjes së njoftimit paraprak dhe kërkesës për kthimin vullnetar të asistuar të viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit, Palët duhet të koordinojnë veprimet dhe bashkërisht të përgatisin një plan masash që ka të bëjë kryesisht me verifikimin e

shtetësisë, pajisjes me dokumentet e duhura të identitetit, analizës së rrezikut, përcaktimin e vendit të referimit për akomodim, si dhe masa të tjera në lidhje me transportin e sigurt të viktimës / viktimës së mundshme së trafikimit, etj.

3. Në raste të veçanta të diktuara nga rreziku që i kanoset fëmijës në shtetin Palë apo si rezultat i nevojave të tij, viktimat/viktimat e mundshme duhet të trajtohet në territorin e Palës ku ndodhet sipas vendimit të Autoritetit Përgjegjës përkatës.

## **Neni 8**

### **Mbrojtja e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit**

1. Palët angazhohen se do të marrin masat e nevojshme për të lehtësuar kthimin vullnetar të asistuar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit brenda një kohe të arsyeshme dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë sigurisë dhe mbrojtjes sociale të viktimave;
2. Autoritetet Përgjegjëse të Palëve, brenda kompetencave dhe kuadrit ligjor të brendshëm, në lidhje me viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, duhet të:
  - a. kryejnë intervistimin nga një grup i përbërë nga ekspertë të fushave të ndryshme dhe plotësimin e nevojave të veçanta që kanë të bëjnë me shëndetin, ushqimin, strehimin, arsimimin, sigurinë, etj.;
  - b. mundësojnë qëndrimin e përkohshëm ose të përhershëm, në territoret e tyre sipas nevojave të rastit dhe duke marrë në konsideratë interesin më të lartë të viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit;
  - c. pajisin me dokument identiteti, leje qëndrimi (të përkohshme/të përhershme) viktimat/viktimat e mundshme shtetas të Palës tjetër, të cilët për arsye të ndryshme (reflektimi, rehabilitimi, riatdhesimi, apo për të bashkëpunuar me organet e drejtësisë) dëshirojnë të qëndrojnë në territorin e shtetit pritës;
  - d. ofrojnë shërbime në mënyrë të pakushtëzuar nga bashkëpunimi me organet e drejtësisë;
3. Për plotësimin e të gjitha nevojave dhe shërbimeve të ndryshme, Autoritetet Përgjegjëse bashkëveprojnë me njëri-tjetrin dhe bashkëpunojnë me agjenci dhe struktura të tjera që ofrojnë shërbime për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit brenda vendit të tyre.

## **IV**

### **KOMUNIKIMI MIDIS PALËVE**

## **Neni 9**

### **Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit**

1. Palët bien dakord për mjetet dhe për mënyrën e shkëmbimit të informacionit, si dhe caktojnë personat e kontaktit, të cilët do të veprojnë në emër të Autoriteteve Përgjegjëse për zbatimin e këtij Protokolli.
2. Secili nga Autoritetet Përgjegjëse të caktuara nga Palët sipas këtij Protokolli, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e tij, cakton një pikë kontakti (duke detajuar emër/mbiemër, funksionin dhe kontaktet përkatëse) me qëllim që të sigurohet efikasiteti në vazhdimësi i bashkëpunimit të Palëve në shkëmbimin e informacionit, çështjeve operative dhe gjatë procesit të identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit vullnetar të asistuar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.
3. Komunikimi midis Autoriteteve Përgjegjëse sipas këtij Protokolli dhe personave të emëruar të kontaktit kryhet në gjuhën shqipe, malazeze dhe angleze. Për çdo ndryshim të mundshëm të personave të kontaktit, Palët njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën.

## V MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

### Neni 10 Mënyra e shkëmbimit të të dhënave

1. Shkëmbimi i informacionit të konsiderohet konfidencial dhe përdoret vetëm nga Autoritetet e caktuara Përgjegjëse sipas këtij Protokoll. Ky informacion duhet të përdoret në përputhje me qëllimet e përcaktuara në këtë Protokoll dhe nuk i komunikohet apo përcillet një shteti të tretë, me përjashtim të rasteve kur ka miratim me shkrim nga Autoriteti i caktuar Përgjegjës iniciues.
2. Autoritetet e caktuara Përgjegjëse, sipas këtij Protokoll, garantojnë mbrojtjen e të dhënave të fshehta, të marra në zbatim të dispozitave të këtij Protokoll në përputhje të plotë me legjislacionin e tyre kombëtar.
3. Autoritetet e caktuara Përgjegjëse, garantojnë që fshirja ose shkatërrimi i çdo lloj të dhëne apo informacioni të marrë në zbatim të dispozitave të këtij Protokoll do të kryhet në përputhje të plotë me legjislacionin e tyre kombëtar.

### VI Neni 11

#### Mbulimi i shpenzimeve

1. Shpenzimet që kanë lidhje me zbatimin e dispozitave për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin, të përcaktuara në Nenin 4 të këtij Protokoll Shtesë, si dhe shpenzimet që lidhen me takime dhe vizita të ndërsjella delegacionesh, përballohen në mënyrë reciproke.
2. Shpenzimet që lidhen me referimin dhe kthimin vullnetar të asistuar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, në zbatim të Marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi për "Për ripranimin e personave, hyrja ose qëndrimi i të cilëve është i paligjshëm", administrohen sipas dispozitave të Nenit 10 të Marrëveshjes.

### VII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

#### Neni 12 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Ky Protokoll Shtesë interpretohet së bashku me Marrëveshjet. Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij Protokoll, zgjidhet me anë të konsultimeve midis Autoriteteve të caktuara Përgjegjëse në bazë të këtij Protokoll, në kuadër të takimeve të përbashkëta.

**Neni 13**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Protokoll hyn në fuqi ditën e 30-të pas nënshkrimit të tij nga Palët.

Ky Protokoll mund të ndryshohet ose plotësohet me propozimin e Palëve, duke njoftuar Palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Nënshkruar në .....<sup>Tiranë</sup>....., më .....<sup>8 dhjetor 2014</sup>....., në dy kopje origjinale secila, në gjuhën shqipe, malazeze dhe angleze ku të gjitha tekstet janë një lloj autentike. Në rast të mosmarrëveshjeve në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

**PËR**

**Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës  
së Shqipërisë**

**KOORDINATORI KOMBËTAR PËR LUFTËN  
KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE  
ELONA GJEBREA - HOXHA**

---

**PËR**

**Sekretariatit e Përgjithshëm të Qeverisë së Malit të  
Zi – Zyra për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve  
Njerëzore  
e Malit të Zi**

**KOORDINATORI KOMBËTAR PËR LUFTËN  
KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE  
ZORAN ULAMA**

---